

RELACION TEKNIK

Objekti “Riveshje dhe sistemim asfaltim Nyja Shkozet – Mbikalimi Plepa”

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM


Projekt – zbatimi i objektit “Riveshje dhe sistemim asfaltim Nyja Shkozet – Mbikalimi Plepa” është hartuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Ky segment, pjesë e anahkalimit të Durrësit, është shumë i rëndësishëm pasi shërben për lidhjen e superstradës Tiranë – Durrës nga Nyja e Shkozetit deri në Mbikalimin e Plepave ku lidhet me rrugën Tiranë – Ndroq – Plepa dhe rrugën Plepa – Kavajë – Rrogozhinë.



Të gjitha mjetet e zonës së veriut që lëvizin drejt jugut dhe ato të Portit të Durrësit kalojnë në këtë segment rrugor.

Ky segment rrugor ku do të ndërhyet ka një gjatësi prej 4.2 km me dy karrexhata me trafikndarës tip në jersey, me gjerësi të shtresës asfaltike 7 m në të dy senset e lëvizjes.

PROFILI TERHOR TIP



Rruga kalon nëpër një zonë të dendur urbane dhe i nënshtrohet një trafiku të rënduar ku një pjesë të madhe e zë trafiku i mjeteve të rënda.

Shtresat asfaltike janë të dëmtuara me gropëzime, çedime, rrjetëzime etj.

Shtresa e asfaltotapetit është e konsumuar dhe e rrjetëzuar në të gjithë sipërfaqen dhe për të gjithë këtë gjatësi. Shtresa e binderit është e dëmtuar në pothuaj 30% të sipërfaqes së asfaltuar.

Paraprakisht, theksojmë se paketa e shtersave është ruajtur si ajo ekzistuesja, 4cm asfaltobeton dhe 6cm binder.

Ndërhyrja parashikon skarifikimin (frezimin) e të gjithë shtresës së tapetit dhe shtresën e binderit në rreth 30% të sipërfaqes. Gjithsesi pas heqjes së shtresës së tapetit do të përcaktohet saktë sipërfaqja dhe thellësia e saktë e ndërhyrjes në shtresën e binderit dhe nënshtresat e tjera. Pas frezimit do të vazhdohet me profilimin e shtresës së binderit me trashësi 6cm dhe asfaltimin e shtresës së tapetit me trashësi 4cm.

Më tej sinjalistika horizontale e vijëzimit gjatësor me gjerësi 15cm dhe shenjave të trafikut do të bëhet me bojë termoplastike sprajt. Sinjalistika vertikale do të jetë si plotësim i asaj ekzistuese.

Planin i menaxhimit të trafikut do të jetë i ndryshueshëm sipas avancimit të punimeve që do të thotë që rrugët alternative për devijimin e trafikut do të ndryshojnë në vazhdimësi deri në përfundimin e punimeve. Ai do të përgatitet nga kontraktori në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe do të miratohet nga Autoriteti Kontraktor në Bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë.

Grupi i punës: